

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor



Kalendari i ditëve të shëndetit dhe mbrojtjes sociale

7 PRILL 2019 DITA BOTËRORE E SHËNDETIT

Data zyrtare: 7 Prill

Dita Botërore e Shëndetit është një ditë që festohet çdo vit më 7 prill, nën sponsorizimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe organizatave të tjera.

Në vitin 1948, OBSH mbajti Asamblenë e Parë Botërore të Shëndetit. Kuvendi vendosi të festojë 7 prillin e çdo viti, me efekt nga viti 1950, si Dita Botërore e Shëndetit.

Dita Botërore e Shëndetit është mbajtur çdo vit për të shënuar themelimin e OBSH dhe është parë si një mundësi nga organizatat për të tërhequr vëmendjen në mbarë botën për një temë me rëndësi të madhe për shëndetin botëror. OBSH organizon ngjarje ndërkombëtare, rajonale dhe vendore në Ditën e Shëndetit që lidhen me një temë të caktuar.

Dita Botërore e Shëndetit pranohet nga qeveritë e ndryshme dhe organizatat joqeveritare me interesa në çështjet e shëndetit publik, të cilët gjithashtu organizojnë aktivitete dhe theksojnë mbështetjen e tyre.

Health is a human right.

It's time for universal health coverage.

HEALTH FOR ALL

World Health Organization

www.who.int/whd19

Primary health care is the most efficient and effective way to achieve health for all.

But too often, it is the most under-resourced part of the health system, with the biggest gaps in poor and marginalized communities.

We must act now to ensure no-one is left behind.

World Health Organization

To make universal health coverage a reality we need...

World Health Organization

individuals and communities who are empowered to take care of their health and the health of their families;

skilled health workers providing quality, people-centred care;


and policy-makers committed to investing in primary health care.

Health is a human right, it's time for HEALTH FOR ALL

Fokusi kryesor: Mbulimi shëndetësor universal

Synimi kryesor i OBSH është mbulimi shëndetësor universal, me qëllim sigurimin e të gjithë personave me shërbimet shëndetësore që ju nevojiten, kur ju nevojiten, në komunitetin e tyre dhe pa barra të rënda financiare.

- Sivjet më datë 7 Prill, Ditën Botërore të Shëndetit, OBSH ka në fokus mbulimin shëndetësor universal. Qëllimi është të ndihmojë njerëzit të kuptojnë më së miri se për çfarë shërbimesh dhe mbështetje kanë nevojë. OBSH i bën thirrje personave të cilët kanë akses në kujdes shëndetësor cilësor dhe të përballeshëm të përkrahin nismën për akses të barabartë për të gjithë.
- OBSH e vlerëson ndikimin që kanë profesionistët e kujdesit shëndetësor në proceset e vendimmarrjes në shëndetësi, pasi ata e dinë se për çfarë njerëzit kanë nevojë sidomos në kujdesin parësor. Fushata e Ditës Botërore të Shëndetit paraqet një mundësi për ministritë e shëndetësisë dhe organet e tjera vendimmarrëse ose për të vënë në dukje progresin që ata kanë bërë.
- Mjaft vende vazhdojnë të përballesh me realitetin ku duhet ti ofrojnë popullit të tyre akses në shërbime cilësore brenda burimeve ekonomike të kufizuara, gjë që e bënë mjaft të qartë ndikimin thelbësor të politikave në mbulimin shëndetësor.
- Dita Botërore e Shëndetësisë është një mundësi për të përçuar mesazhin mbi rëndësinë e barazisë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, jo vetëm në të mirë të shëndetit të personave por edhe në të mirën e ekonomisë dhe shoqërisë.
- Ka pasur përparime në të gjitha vendet e rajoneve nëpër botë. Miliona njerëz ende nuk kanë akses në të gjitha fushat e kujdesit shëndetësor. Miliona të tjerë janë të detyruar të zgjedhin mes kujdesit shëndetësor dhe shpenzimeve të tjera ditore si ushqimi, veshja ose shtëpia.



Fushata sensibilizuese

Çfarë synojnë të arrijnë përmes fushatës

- Kjo fushatë synon që ti vijnë në ndihmë njerëzve nëpërmjet një panorame sa më të qartë të asaj çka është mbulimi shëndetësor universal, çfarë shërbimesh dhe mbështetje duhet të kenë në dispozicion dhe në çfarë vendi.
- Kjo fushatë do i shërbej edhe ministrive të shëndetësisë dhe organeve të tjera vendimarrëse në përbushjen e boshllëqeve që kanë në vendet e tyre në mbulimin shëndetësor universal si dhe do të hedhi dritë mbi vendet që kanë bërë përparime në këtë aspekt.
- Në Ditën Botërore të Shëndetësisë, OBSH do të publikojë Raportin Botëror të Statistikave Shëndetësore, një përmbledhje vjetore me të dhëna shëndetësore. Raporti do të përfshijë informacione mbi trendet shëndetësore në fusha të caktuara si ajo e të porsalindurëve dhe shëndeti i fëmijëve, sëmundjeve kronike, shëndetit mendor dhe risqeve të mjedisit si dhe të dhëna mbi mbulimin shëndetësor dhe sistemet shëndetësore.

Mesazhet kryesore

- Shëndeti është një e drejtë njerëzore, ka ardhur momenti që të gjithë ta zotërojnë këtë të drejtë.
- Mbulim shëndetësor universal do të thotë se të gjithë personat kanë akses në shërbimet shëndetësore cilësore që ju nevojiten, kur dhe ku ju nevojiten dhe pa barra financiare.
- Çdo vit gjysma e njerëzve në botë nuk përfitojnë shërbimin shëndetësor për të cilin ata kanë nevojë.
- Shëndeti është një e drejtë njerëzore; të gjithë duhet të disponojnë informacionin dhe shërbimet që nevojiten për ta dhe familjet e tyre.
- Cilësia dhe aksesin në kujdesin parësor shëndetësor janë themelet e mbulimit shëndetësor universal.
- Kujdesi shëndetësor parësor duhet të jetë hallka e parë e sistemit shëndetësor, ku individët, familjet dhe komunitetet përfitojnë pjesën kryesore të kujdesit sa më afër vendit ku punojnë dhe jetojnë.
- Kujdesi shëndetësor parësor mbulon shumicën e nevojave shëndetësore përgjatë jetës duke përfshirë këtu desiptimin e problemeve shëndetësore, vaksinat, informacion mbi parandalimin e sëmundjes, planifikimi familjar, trajtimin për gjendje të shkurtër ose të gjatë, koordinimin me nivelet e tjera të kujdesit dhe rehabilitimit.
- Kujdesi parësor shëndetësor është një mënyrë për të ofruar shërbime shëndetësore me një kosto sa më efektive dhe për të ndihmuar vendet të përparojnë drejt mbulimit universal.
- Një sistem shëndetësor me një kujdes parësor të fortë siguron rezultate më të mira shëndetësore, është efikas në kosto dhe përmirëson cilësinë e kujdesit.
- Punonjësit e shëndetësisë kanë një rol kryesor në edukimin e pacientëve sesi të kujdesen për shëndetin e tyre, të bashkërendojnë kujdesin dhe të kërkojnë të drejtat e pacientëve të tyre në përputhje me nevojat tek drejtuesit e tyre dhe politikëbërësit.
- Punonjësit e kujdesit parësor kanë një marrëdhënie vazhdimësie dhe besimi me pacientët e tyre si dhe njohin historikun e tyre shëndetësor; duke pasur panoramën e përgjithshme ata ndihmojnë në përmirësimin e kujdesit dhe kursejnë para.

Aktivitetet që do të mbahen në Shqipëri

Njoftim i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Le të festojmë ditën Botërore të Shëndetit të dielën, datë 7 Prill 2019. Tema e këtij viti është Mbulimi Shëndetësor Universal. Ky event ka për qëllim të ndihmojë qytetarët të kuptojnë çfarë do të thotë Mbulim Shëndetësor Universal dhe cilat janë shërbimet që ofrohen dhe shtrirjen e tyre.

Ky event organizohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe HAP

Aktivitetet

- Panair shërbimesh shëndetësore;
- Shërbimi i Check Up falas për qytetarët;
- Shërbimi i Mamografisë falas do të ofrohet për popullatën target;
- Mbjellje pemësh;
- Mbjellje e pemëve në Parkun e Liqenit dhe shpërndarja e mesazheve mbi rëndësinë e hapësirave të gjelbra për Shëndetin Publik.

Aktivitet Fizik 12:00-13:00

- Seancë Yoga.



BASHKOJU NISMËS

Mos harroni të përdorni hashtag # HealthForAll kur të publikoni mesazhet tuaja mbi Ditën Botërore të Shëndetit, ose të firmosni *peticionin* **Mbulimi Shëndetësor Universal: Për këdo, kudo**, në linkun: <https://www.who.int/campaigns/world-health-day/world-health-day-2019/petition---health-for-all>.

